

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zgjedhjet dhe vonesat institucionale në Kosovë "pengojnë agjendën" me SHBA-në
ADRESA	https://www.cna.al/tech/zgjedhjet-dhe-vonesat-institucionale-ne-kosove-pengojne-agjende-me-shba-ne-i474218
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 11:50:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 11:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	19c3d3dc0b207ff9eb788b32be14d166e4341bbad457f47aa5345c85bf92de13
TEKSTI	1474d24100776038019d26baf93649fbc8761e89bf258dbda0e9107cfe07c853
PAMJA	766ac892a0483ad5c9516ff118d22b9eb7039b91fb62fd1b7728b9b72eaf6e5d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cc624625077d744adde16080153dac3f7ff858c2482393c2059a32285df5b97
E MËPARSHMJA	577d92e7d75e35ce16d099bd5ea6edcf96879d48f7eabda412fc017a0c5acd96
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cc624625077d744adde16080153dac3f7ff858c2482393c2059a322858df5b97>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

14:58 Aktualitet

Ambasadori kroat në vendin tonë, Zlatko Kramariç në një de...

Zgjedhjet dhe vonesat institucionale në Kosovë "pengojnë agjendën" me SHBA-në



15 Shtator 2026, 13:41, Kosova & Bota CNA



Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara ndaj pavarësisë dhe integritetit territorial të Kosovës, por paralajmërojnë se ngërçi i zgjatur politik po e pengon agjendën e përbashkët mes dy vendeve.

Ky pritet të jetë një nga mesazhet kryesore të zëvendësndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, Daniel Lawton, gjatë dëshmisë së tij më 15 shtator para Nënkomisionit për Europën të Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-së.

Në deklaratën e përgatitur për seancën dhe të bërë publike paraprakisht, Lawton përmend zgjedhjet e përsëritura në Kosovë, periudhën e gjatë me qeveri në detyrë dhe vonesat në formimin e institucioneve si faktorë që kanë penguar avancimin e prioritetëve të përbashkëta.

"Kemi një agjendë të gjerë bashkëpunimi me Kosovën, e cila, fatkeqësisht, është penguar nga zgjedhjet e përsëritura, periudha e zgjatur me qeveri në detyrë dhe vonesat në formimin e institucioneve të nevojshme për avancimin e prioriteteve tona të përbashkëta", thuhet në deklaratë.

Uashingtoni, sipas tij, u ka bërë thirrje udhëheqësve të Kosovës që ta përmbyllin procesin e formimit të institucioneve në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e gjykatave.

Por, vërejtjet amerikane shkojnë edhe përtej ngërçit politik.

Lawton pritet të thotë se SHBA-ja ka ngritur shqetësime për atë që e përshkruan si "kontroll të tepruar ligjor dhe policor" ndaj popullsisë serbe të Kosovës.

"Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të gëzojnë të drejta të barabarta dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, nëse Kosova dëshiron ta ruajë stabilitetin", thuhet në deklaratën e tij.

Lawton thekson, gjithashtu, rolin kritik të misionit të NATO-s, KFOR, në ruajtjen e një mjedisi të sigurt në Kosovë - mision në të cilin vazhdojnë të kontribuojnë edhe forcat amerikane.

Dialogu Kosovë-Serbi ka ngecur

Normalizimin e marrëdhënieve dhe ruajtjen e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Lawton pritet t'i cilësojë si thelbësore për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor.

Sipas tij, që nga Marrëveshja e Uashingtonit e vitit 2020, e ndërmjetësuar nga presidenti amerikan, Donald Trump, gjatë mandatit të tij të parë, është bërë "përparim i rëndësishëm".

Megjithatë, ai vlerëson se dialogu i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian ka ngecur, për shkak të "vullnetit të pamjaftueshëm politik nga të dyja palët".

SHBA-ja, sipas deklaratës, vazhdon t'i bëjë thirrje Prishtinës dhe Beogradit që t'i shmangin provokimet, t'i përmbushin zotimet e tyre dhe t'u rikthehen bisedimeve të drejtpërdrejta pa parakushte.

Partneriteti me Serbinë po forcohet

Për marrëdhëniet me Serbinë, Lawton pritet të thotë se Uashingtoni po punon që Shtetet e Bashkuara të jenë "partneri i zgjedhur", me synimin për të kundërshtuar ndikimin e aktorëve kundërshtarë të SHBA-së.

"Përpjekjet tona po funksionojnë dhe partneriteti ynë dypalësh po bëhet më i fortë", thuhet në deklaratë.

Lawton përmend nisjen në korrik të Dialogut Strategjik SHBA-Serbi, i cili përfshin bashkëpunimin në energji, mbrojtje, siguri dhe ekonomi.

Ai e cilëson Serbinë si një "vend kyç në ekuilibrin rajonal" dhe thotë se angazhimi me të do të mbetet i rëndësishëm për mbrojtjen e interesave amerikane.

SHBA-ja kërkon "zgjidhje lokale për probleme lokale"

Në deklaratën e tij, Lawton paraqet edhe prioritetet më të gjera të politikës amerikane në Ballkanin Perëndimor.

Ai thotë se SHBA-ja po u kërkon udhëheqësve të rajonit të mos vazhdojnë të rihapin mosmarrëveshjet e së kaluarës, por të përqendrohen në iniciativa konkrete për të çuar vendet e tyre përpara.

"Ne mbetemi të gatshëm të punojmë me ata që janë të përgatitur të ecin drejt së ardhmes, por kemi pak interes për ata që do të minonin stabilitetin për qëllime vetjake, ose që vazhdojnë të rihapin mosmarrëveshje të dekadave të kaluara", thuhet në deklaratën e Lawtonit.

Ai i referohet edhe qëndrimit të zëvendëssekretarit amerikan të Shtetit, Christopher Landau, se "epoka e ndërtimit të shteteve të imponuara nga jashtë ka përfunduar".

Kjo, sipas Lawtonit, nuk nënkupton tërheqjen amerikane nga Ballkani Perëndimor.

Ai thotë se SHBA-ja mbetet aktive në përpjekjet për rezultate që avancojnë interesat e saj dhe që u mundësojnë aktorëve lokalë t'i gjejnë vetë zgjidhjet.

Tri shtyllat e politikës amerikane

Lawton e ndan politikën amerikane në Ballkanin Perëndimor në tri shtylla: stabiliteti, interesat ekonomike dhe tregtare dhe luftimi i kërcënimeve ndaj SHBA-së.

Stabiliteti, sipas tij, është parakusht për realizimin e të gjitha objektivave të tjera amerikane në rajon.

Në aspektin ekonomik, SHBA-ja synon të avancojë interesat e veta tregtare përmes rritjes së udhëhequr nga sektori privat dhe krijimit të një klime që favorizon investimet dhe bizneset amerikane.

Lawton i përshkruan stabilitetin dhe prosperitetin si objektiva që përforcojnë njëra-tjetrën.

Shtylla e tretë lidhet me kërcënimet ndaj sigurisë, përfshirë organizatat kriminale transnacionale nga Ballkani që bashkëpunojnë me kartelet në hemisferën perëndimore dhe që, sipas tij, përbëjnë kërcënim të drejtpërdrejtë për SHBA-në.

Uashingtoni pret gjithashtu që partnerët evropianë të marrin përsipër një pjesë më të madhe të barrës së sigurisë në rajon.

Nga aleatët e NATO-s në Ballkanin Perëndimor kërkohet modernizimi i ushtrive dhe përmbushja e zotimeve për shpenzimet e mbrojtjes.

Bosnja, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi

Për Bosnje dhe Hercegovinën, Lawton rikonfirmon përkushtimin e SHBA-së ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit dhe stabilitetit të siguruar nga Marrëveshja e Dejtonit.

Ai pritet të thotë se diplomacia amerikane, vitin e kaluar, ndihmoi në zgjidhjen e një krize të gjatë, duke ruajtur kohezionin ligjor dhe rendin kushtetues të vendit dhe duke siguruar tërheqjen e legjislacionit të Republikës Srpska që ishte në kundërshtim me Marrëveshjen e Dejtonit.

Lawton veçon edhe projektin e gazsjellësit të Interkoneksionit Jugor me Kroacinë, i cili, sipas tij, do të diversifikojë furnizimin me energji të Bosnje dhe Hercegovinës dhe do të krijojë mundësi për kompanitë amerikane.

Në Shqipëri, SHBA-ja po punon me autoritetet për luftimin e organizatave kriminale transnacionale dhe zgjerimin e qasjes së kompanive amerikane në treg.


Lawton përmend edhe një kredi të sapopërfunduar në kuadër të Financimit të Huaj Ushtarak, e cila, sipas tij, do ta ndihmojë Shqipërinë të përmbushë zotimet për shpenzimet e mbrojtjes në NATO dhe të rrisë blerjen e pajisjeve të prodhuara në SHBA.

Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, Lawton i përshkruan si aleatë të afërt të NATO-s dhe partnerë të SHBA-së në fushën e sigurisë.

Për Maqedoninë e Veriut, ai veçon bashkëpunimin në mbrojtje, energji dhe infrastrukturë, si dhe Dialogun Strategjik SHBA-Maqedoni e Veriut të zhvilluar në prill.

Për Malin e Zi, Lawton përmend marrëveshjen ndërqeveritare të arritur së fundmi me SHBA-në, e cila krijon korridorë për bashkëpunim, përfshirë në Korridorin Adriatiko-Jonian.

Sipas Lawtonit, angazhimi amerikan në Ballkanin Perëndimor do të lidhet me objektiva të arritshme dhe rezultate të matshme, me fokus te zgjidhjet e drejtuara nga vetë vendet e rajonit, bashkëpunimi ekonomik dhe i sigurisë dhe avancimi i interesave amerikane. /REL



Të sugjeruara

[Kufizimi i votimit me postë/ Gjykata Supreme bllokoi planin e Trump](#)

Nesër gjyqi në Hagë/ Kush janë gjyqtarët që kanë në dorë fatin e ish-krerëve së UÇK-së

Dy anije peshkimi goditen me dronë në Gjirin Persik/ Disa persona të zhdukur

"Aleanca unike" me delegacion/ BE do të hapë zyrë në Kanada

Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme/ NATO rrëzon një dron në Lituani

SHBA-ja konfirmon për herë të parë se ka vendosur armë në hapësirë

Hetimet për korrupsion/ Zelensky kërkon shkarkimin e prokurorit të përgjithshëm të Ukrainës

Paralajmërimi se IA mund të shkatërrojë njerëzimin/ Trump: Është një mashtrim

Vuçiç: Do të jap dorëheqjen si president më 27 shtator

Marrëveshja e njoftuar nga Trump/ Zelensky: Dyshoj në gatishmërinë e Rusisë për ta zbatuar

U propozua nga LVV dhe LDK/ Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për president

Mbyllet aeroporti i Katanias/ Shkak aktivizimi i vullkanit Etna

"Çmimi i naftës u rrit nga lufta e tyre, jo nga Irani"/ Trump njofton marrëveshjen mes Ukrainës dhe Rusisë

BE: I takon Kushtetueses ta gjykojë formimin e Qeverisë dhe të Kuvendit

Rutte: KFOR-i është aty, pavarësisht çfarë mund të ndodhë këtë javë në Kosovë

"Një rol strategjik dhe më proaktiv"/ 12 vende i kërkojnë BE-së të forcojë praninë në Arktik

Kurti bën thirrje për bashkëpunim në zgjedhjen e presidentit të ri

Dronët rusë sjellin luftën deri në Moldavi dhe Rumani

Zgjedhjet në Berlin mes radikalizimit të politikës

CDU fiton zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme

[editorial](#)

13:52 Editorial Elvi FUNDO

Erion Veliaj nuk i lë prokurorisë asnjë mundësi për ta harruar

CNA LIVESTREAM



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.